

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga INFINUM shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për veprimtari kompjuterike dhe shërbime (Infinum društvo s ograničenom odgovornošću za računalne djelatnosti i usluge) (INFINUM d.o.o.), me seli të regjistruar në adresën Rr. Mala Shvarça 23, Karlovac, Kroaci, dorëzuar përmes shoqërisë së avokatëve Polenak, nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 19.11.2025, solli këtë:

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin INFINUM shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për veprimtari kompjuterike dhe shërbime (Infinum društvo s ograničenom odgovornošću za računalne djelatnosti i usluge) (INFINUM d.o.o.), me seli të regjistruar në adresën Rr. Mala Shvarça 23, Karlovac, Kroaci, përmes shoqërisë së tij të varur indirekte INFINUM CYBERSECURITY BIDCO LIMITED me seli të regjistruar në Njësia 2, rruga Weller 14, Londër, SE1 1QU, Angli (Unit 2, 14 Weller Street, London, England SE11QU), do të fitojë kontroll mbi AMR Cybersecurity Ltd me seli në 3000A Parkway, Whiteley, Hampshire, PO15 7FX, MB (3000A Parkway, Whiteley, Hampshire, PO15 7FX, UK), edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria për pagesë 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 15.10. 2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftimi për përqendrim nga INFINUM shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për veprimtari kompjuterike dhe shërbime (Infinum društvo s ograničenom odgovornošću za računalne djelatnosti i usluge) (INFINUM d.o.o.), me seli të regjistruar në adresën Rr. Mala Shvarça 23, Karlovac, Kroaci, me të cilën INFINUM shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për pjesë kompjuterike dhe shërbime përmes shoqërisë së tij të varur indirekte INFINUM CYBERSECURITY BIDCO LIMITED (INFINUM CYBERSECURITY BIDCO LIMITED), me seli të regjistruar në Njësia 2, rruga Weller 14, Londër, SE1 1QU,

Angli (Unit 2, 14 Weller Street, London, England SE11QU), do të fitojë kontroll mbi AMR Cybersecurity Ltd me seli në 3000A Parkway, Whiteley, Hampshire, PO15 7FX, MB (3000A Parkway, Whiteley, Hampshire, PO15 7FX, UK)

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit me ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij konstatoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Veprimtaria primare e regjistruar e INFINUM d.o.o. është programimi kompjuterik.

Aktiviteti primar afarist i INFINUM BIDCO janë aktivitetet e konsulencës në teknologjinë e informacionit.

Në Maqedoninë e Veriut, INFINUM d.o.o. ka një shoqëri të varur të regjistruar – Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime INFINUM SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. Maksim Gorki nr.13, 1000 Shkup dhe NUAS (EMBS) 6683150. Veprimtaria prioritare e regjistruar e INFINUM SHPKNJP Shkup është 62.09 – shërbime të tjera në lidhje me teknologjinë e informacionit dhe kompjuterët.

Veprimtaria primare e AMR Cybersecurity Ltd janë shërbime të specializuara të sigurisë kibernetike.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, sepse plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ